

## **MENDIME TË KËSHILLIT TË FAKULTETIT MBI DRAFTIN PËR REFORMIMIN E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT SHKENCOR**

Reforma në arsimin e lartë ka për qëllim fuqizimin e autonomisë akademike dhe financiare, në të cilën të mundësohen kushte më të mira për realizimin e programeve mësimore dhe të punës kërkimore, për t'i bërë universitetet si qendra të rëndësishme të progresit social, teknologjik dhe shkencor. Këshilli i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në mbledhjen e tij të datës 20.05.2014 diskutoi mbi draftin e përgatitur nga Komisioni për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor.

Duke marrë në konsideratë dhe diskutimet e bëra në çdo departament të këtij fakulteti, ky Këshill gjykon se arsimi ynë i lartë ka nevojë për reforma që të ndikojnë në përmirësimin cilësor të funksionimit të tij dhe gjithashtu mendon se me kete draft te propozuar do te jete e veshtire te arrihen objektivat e parashikuara nga komisioni I ngritur per kete qellim. Modeli i reformimit që propozohet është i vështirë të realizohet në kushtet e vendit tonë, për specifikat që tashmë janë të njohura.

Pjesa më e rëndësishme e materialit ka të bëjë me problematikat që shfaqen në draftin e parë të komisionit.

Drafti i parë për reformimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, mendojme cënon parimet bazë të arsimit të lartë si Autonomia dhe Demokracia. Universitetet shqiptare kanë një përcaktim të dhënë qartë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, që është autonomia. Ato duhet të funksionojnë si institucione autonome. Neni 57, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: **“Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj”**

Reforma që paraqet drafti ka një kosto të lartë dhe barra bie mbi studentët. Buxheti i shtetit për arsimin varion nga 2.2% në 2.8% e PPB dhe për arsimin e lartë nga 0.4% - 0.6% të PPB-së, sipas draftit. Këto vlera janë të vogla. Prandaj për të rritur mbështetjen në arsimin e lartë duhet që shteti të rrisë në mënyrë progresive sipas rekomandimeve deri në 5% të PPB, në të cilën arsimi i lartë të përfitojë po në mënyrë progresive deri në 2% të PPB. Në këtë mënyrë kostoja e studentit shkon nga 1200 deri 1500 euro. Në këto kushte qeveria duhet të shprehet për rritjen e mbështetjes së Arsimit të Lartë duke garantuar rritjen e cilësisë në këto institucione. Kontributi i të ardhurave me anë të donacioneve, projekteve, pushtetit lokal etj., do jetë shumë i vogël dhe për pasojë, nëse nuk ka mbështetje barra bie totalisht mbi studentët.

Në draft theksohet me të drejtë se ka pedagogë që janë punësuar në shumë institucione njëkohësisht dhe se ndalohet dypunësimi i tyre, gjë që ka qenë edhe shqetësimi ynë. Por kjo gjë bie ndesh në radhë të parë me Kodin e Punës. Nuk është e qartë se ç'kuptohet me dypunësim që duhet të ndalohet sipas reformës, kur procesi i Bolonjës stimulon mobilitetin e profesorëve dhe studentëve në Zonën Europiane të Edukimit. Propozimi për ndalimin e dypunësimit duhet të shoqërohet në draft me prezantimin e rrugëve të garantuara financiare që bëjnë të panevojshme dy punësimin. Ndalimi i dypunësimit duhet sqaruar. Nëse bëhet fjalë që pedagogët e një Universiteti të mos japin mësim në Universitete të tjera si të jashtëm, atëherë kjo nuk na duket e arsyeshme për dy arsye themelore: e para në këtë rast do pengojë shkëmbimi i eksperiencave ndërmjet Universiteteve Publike por edhe private, dhe së dyti do ulej shumë niveli ekonomik i një mase të madhe njerëzish (Aktualisht pagat e pedagogëve tanë janë thuhet gjysma e pagave të homologëve në vendet fqinje Kosovë, Maqedoni). Të mos çenohet dypunësimi kur bëhet fjalë për aktivitete jashtë orarit zyrtar, e sidomos në rastet kur nuk përbën konflikt interesi. Kjo gjë të shihet lidhur edhe me pagesat e stafit akademit, që do të sillte në vend dinjitetin e tyre, krahasimin me pagesat e vendeve deri në rajon, dhe zvogëlimin e domosdoshmërisë së dypunësimit të tyre.

Gjykojmë se Granti i punës kërkimore-shkencore për IAL nuk është i qartë, përse duhet të jepet në masën 10% për IAL publike të rankuara të akredituara, dhe pjesa tjetër prej 20% tu jepet gjithë IAL-ve. Këto fonde shpërndahen nga AKKSH mbi bazë merite/aplikimi, ndaj nuk është e qartë pse vetëm 10% e financimit total të shtetit për IAL-të duhet të përdoret për IAL publike, ndërsa IAL e tjera që mund të jenë të parankuara dhe të paakredituara, pra nga pikepamja e meritës lënë për të dëshiruar, do të mund të aplikojnë për 20% të buxhetit total. Tek paragrafi "Granti i Punës Kërkimore- Shkencore" ku flitet për grantet që mund të përfitojnë IAL për "pjesën e mirëfilltë shkencore" *thuhet se mund të përfitojnë nga fondet publike edhe IAL private!* Cili është argumentimi dhe baza ligjore e këtij financimi dhe sa do të jetë masa e financimit? Shprehja "mbi bazë merite/aplikim" është evazive dhe nuk sqaron arsyet e këtij sygjerimi! Po ashtu paragrafi "Granti i Mësimdhënies" flet për *përfitime bursash nga edhe nga studentë të IAL private!* Përsëri shtrohet pyetja se cila është baza ligjore e këtij propozimi dhe cila është masa e bursës, pra bursat për studentët e IAL publike dhe private do jenë të njëjta!? Përse u dashka të përfitojë një biznes privat të ardhura publike, në rast se kjo është menduar kështu përse nuk e paskan këtë të drejtë që të përfitojnë fonde publike edhe shkollat e tjera private të niveleve më të ulëta!

Universitetet publike dhe ato private theksohet se do të trajtohen në periudhën e dytë të reformës si fondacione. Me zbatimin e këtij projekti, Shteti financon Universitetet e tipit fondacion me themeltar krijuesin, që

rrjedhin nga Universitetet e sotme private, disa prej të cilëve janë me një të shkuar piramidale në aspektin financiar, me një të shkuar “të errët” në cilësinë e diplomave dhe pa asnjë kontribut shkencor. Nuk shohim asnjë arsye përse shteti duhet ta bëjë një gjë të tillë. Universitetet private janë hapur si biznese dhe shteti nuk ka asnjë detyrim për mbarëvajtjen e tyre, përveç kontrollit të vazhdueshëm, deri tani të munguar, për cilësinë e tyre, për zbatimin e ligjit prej tyre dhe të financave të tyre. Si ka mundësi që shteti të financojë këto ndërmarrje fitimprurëse, që do të na kthehen në fondacione, që i kanë thithur vendit edhe sipas vet raportit më shumë para se sa i tërë sistemi shtetëror edhe pse kanë më pak se 25% të numrit të studentëve. Në këtë fazë, fondet për mësimdhënie nga buxheti shtetit do të jepen vetëm për universitet me status të njëjtë. Këtu i referohemi gjykimit që në këtë fazë është parë e arsyeshme krijimi i një status të ri-UNIVERSITETIT PUBLIK, të tipit FONADACION, ku mund të futen universitetet publike, por ai le të hapur rrugën që dhe universitete jo publike t'i bashkëngjiten këtij grupimi. *Kjo do t'u mundësonte këtyre universiteteve hapësira për të kërkuar financim nga buxheti i shtetit për bllokun e mësimdhënies.* Këtu duhet nënvizuar që universitetet të cilat i bashkëngjiten këtij grupimi (statusi) duhet të zbatojnë të njëjtat rregulla në funksionimin e tyre, si në organizim ashtu edhe për mirëqeverisje. Në rastet kur universiteti privat kërkon të marrë statusin e ri të një universiteti të tipit të Fondacionit, pronari/ët heqin dorë nga pronësia dhe marrin meritën dhe statusin e themeluesit, - duket si një artificë për të përfituar nga fonde publiket edhe IAL private! Edhe në këtë rast kemi të njëjtin arësytim" Përse u dashka të përfitojë një biznes privat të ardhura publike? *E vlerësojmë si aspak të dobishme për universitetin (si privat ashtu edhe atë publik) kthimin e tyre në fondacione.* Ne i mbështesim universitetet private si komplementarë të arsimit të lartë, me kusht që ato të plotësojnë, ashtu si dhe ne, të gjitha standardet akademike dhe universitare.

Kundërshtohet, qoftë edhe për fazat në vijim, futja e institucioneve private (universitete, kolegje apo shkolla të larta) në skemën e financimit shtetëror. Shteti duhet të organizojë politika, për pritshmërinë e rritjes së numrit të studentëve apo edhe të kurrikulave për t'i përballuar ato plotësisht. Duket sikur Shteti në këtë draft Reformë synon një braktisje të fundit të Universiteteve Publike, duke e çuar sipas tij drejt një “pavarësie të plotë”. Kjo e fundit përbën edhe një kontradiktë sepse po sipas këtij drafti, Shteti me agjensitë financuese të tij do të ndikojë fuqishëm në kufizimin e lirive të Universiteteve. Nga ana tjetër Universitetet publike nuk mund të jenë plotësisht të pavarura ose nëse do jenë të tilla, do jenë për të shkatërruar veten e tyre. Ne mendojmë se, nga pikëpamja e menaxhimit dhe financimit, universitetet duhet të marrin statuse të institucioneve tashmë të njohura nga Kushtetuta jonë, siç është autonomia vendore, prandaj propozojmë që të bëhet ndryshimi në Ligjin e Buxhetit,

ku universitetet të trajtohen së bashku me pushtetin vendor, pra, të dalin nga institucionet e varësisë me destinacione të kontrolluara. Gjithashtu duhet bërë ndërhyrje në ligjin e prokurimeve ose në aktet nënligjore të tij, ku arsimi i lartë të ketë një frymëmarrje për shkak të specifikave që ka.

Drafti cënon rëndë autonominë e universiteteve publike nëpërmjet pushtetit absolut që i jep bordit administrativ dhe menaxherëve të varur prej tij. Drafti krijon një model universitar burokratik, ku në qendër janë menaxherët dhe nuk tregojnë asnjë interes për stafin akademik dhe studentët, të cilët përfaqësojnë dy shtyllat e domosdoshme të sistemit universitar.

Organi më i lartë i IAL duhet të jetë Bordi i Administrimit, etj. Propozojmë të përcaktohet raporti i lejuar ndërmjet anëtarëve të Bordit që janë pjesë e stafit të IAL dhe atyre nga jashtë IAL, pasi politikat afatmesme dhe afatgjata duhet të dirigjohen nga nevojat e IAL. Ngritja e strukturave menaxheriale në nivel departamenti është një kosto e madhe, ndërkohë që ne nuk kemi fonde për stafin akademik. Mbiqërkohet roli menaxherial mbi atë akademik. Kjo shprehet qartë edhe në mënyrën e trajtimit të bordit menaxherial, ndërsa për stafin akademik nuk thuhet asgjë në lidhje me trajtimin financiar. Po në këtë kuadër është momenti i pozicionimit të stafit ndihmës mësimor (laborantët), ku më e arsyeshme ishte inkuadrimi i tyre në strukturën e Departamentit.

Nëse Menaxheri i Departamentit do të merret me nevojat administrative të departamentit dhe nëse do të ketë një staf administrative në varësi, çfarë do të bëhet me administratën aktuale e cila menaxhon fondet dhe shërbimet e fakultetit?! Cili do t'i menaxhojë ambjentet e përbashkëta? Cili do të realizojë marrëdhëniet jashtë fakultetit? Çfarë investimesh duhen për të matur konsumin e energjisë, ujit dhe e materialeve e shërbimeve të përbashkëta e përfituar nga çdo departament? A do të bëjë kjo të rritet artificialisht numri i punonjësve administrativë? Drafti nuk shpreh asgjë për autoritetet akademike si rektori, dekani, përgjegjësi i departamentit. Lihet në terr edhe roli i këshillit të fakultetit, i senatit dhe i këshillit të profesorëve. Organigrama e menaxhimit të universiteteve të mbetet në thelb kjo që është sot, natyrisht duke bërë përmirësime apo ndryshime të pjesshme, duke qartësuar më mirë funksionet e strukturave menaxhuese dhe, në të gjitha rastet, ku të mbizotërojë vizioni akademik mbi vizionin menaxherial. Tani kemi një përvojë, e cila na jep mundësi për të bërë ndreqjet e nevojshme.

Duke qenë se vendi ynë i përket vendeve që nuk kanë demokraci të stabilizuar, votimi i drejtëpërdrejtë i autoriteteve drejtuese është zgjidhja më e mirë. Këshilli është i mendimit që zgjedhja e autoriteteve të bëhet drejtëpërdrejtë nga stafi akademik dhe jo akademik si dhe studentët në

rastin e Dekanit dhe Rektorit, deri në dy mandate radhazi. Po ashtu dhe përgjegjësi i Departamentit duhet të zgjidhet me votë të drejtëpërdrejtë të stafit akademik dhe jo akademik të tij, deri në dy mandate radhazi. Heqja e së drejtës së votës të studentëve në zgjedhjet për rektor dhe dekan është një shkelje e hapur e të drejtës legjitime të studentit në Arsimin e Lartë Publik.

Në lidhje me emërimet e reja, mënyra e propozuar për rekrutimin e stafit të ri akademik nuk është efikase. Mënjanimi i Departamentit në përzgjedhje zbeh ndjeshëm objektivitetin e përzgjedhjeve. Përbërja e komisioneve të marrjes së personelit kërkimor-shkencor në departamente duken mosbesuese ndaj vlerësimit nga trupa me anëtarë të fakultetit dhe universitetit. Sugjerojmë që në përbërjen e komisionit “ad hoc”, pesha kryesore të jetë nga anëtarët e Departamentit, Grupit përkatës, ku bëhet pranimi, i cili njeh më mire nevojat për staf mësues dhe kërkimor, dhe të përcaktojë modalitetet e kriterëve. Propozojmë që, komisioni *ad hoc* i emëruar të mos emërohet nga stafi menaxherial dhe ketë 3 anëtarë nga departamenti dhe 2 anëtarë nga departamente analoge, në mënyrë që mendimi i departamentit të marrë rëndësinë e duhur në përzgjedhjen e stafit të ri. Miratimi i komisionit ad-hoc të bëhet nga Dekani ose Rektori, me propozim të departamentit përkatës.

Nisur nga situata financiare e paraqitur, dhe kostot, mendojmë se doktoranti nuk duhet të paguhet nga universiteti, por të mbahet standarti i tanishëm ku vetë doktoranti paguan kostot e udhëheqjes. Kjo pikë, bie ndesh edhe me pikat e tjera ku për Ciklet e tjera veç Bachelorit, pagesa e studentit të përcaktohet sipas kostos, sipas tregut. Për studimet e doktoratës: si pjesë e sistemit të shkollimit të ciklit të tretë, jemi dakord me propozimin, që ajo të kryhet me kohë të plotë pranë departamenteve, si pjesë e veprimtarisë mësimore shkencore të tyre, por me program studimi (me një numër disiplinash të formimit dhe të specializuara në funksion të tematikës studimore) dhe jo sikurse propozohet në dokumentin e reformës, vetëm me aplikim të temës studimore. Propozimi për të atashuar doktorantët pranë Departamenteve ku do punojnë për Doktoratën është ide shumë e mirë. Ata pak student të tillë mund të punësohen në Departament me kontratë përsa kohë punojnë për doktoratën duke dhënë mësim, kështu që për ta zgjidhet problemi financiar dhe njëkohësisht, departamenti zvogëlon numrin e pedagogëve të jashtëm, që aktualisht është shumë i madh. Mënjanimi në draft i doktoraturave teorike dhe realizimi vetëm i doktoraturave eksperimentale cënon ecurinë e kërkimit shkencor në drejtime fundamentale teorike. Sugjerojmë që të lihet një hapësirë për doktorata teorike në disa fusha të veçanta, si Matematikë, Fizikë. Mëdyshja për nivelin e cilësisë së këtyre doktoratave mund të zgjidhet duke përmirësuar ligjin për doktoraturat dhe duke forcuar rregullat për realizimin e tyre.

Përmirësimi i situatës shihet tek ndryshimet, gjoja strukturore. Në fakt vetë strukturat nuk zgjidhin ndonjë gjë të madhe, po që se mungojnë mjetet. Propozimet e strukturave të reja (AKKSH, AKF, AKAU, ASCAL), janë më shumë riemërtime të strukturave ekzistuese si AKTI, AKP etj. Në këtë rast duket sikur duan të krijojnë iluziuonin e ndryshimit dhe reformimit.

Materiali nuk flet asgjëkundi për IAL-të private: Rregullat e lojës që propozohen i lënë jashtë këto? Apo me këtë document ato legalizohen dhe çdo dallim në dukje mes tyre është zhdukur?

Programet e studimit të Mësuesisë të trajtohen me status të veçantë. Pra, të ketë jo vetëm Universitete me status të veçantë por edhe programe studimi me status të veçantë. Duhet të përcaktohet qartë që programet e studimit në Matematikë, Fizikë etj., dhe në mënyrë të veçantë programet e Mësuesisë në këto fusha të kosiderohen si prioritet kombëtar dhe të financohen totalisht nga shteti. Këtu propozojmë që MAS të shpall për çdo vit parashikimet për vende pune në afate 4-5 vjeçare jo vetëm në mësuesi por edhe në profesionet e tjera. Ky është një informacion i nevojshëm për orientim ndaj tregut të punës edhe pse ky sugjerim nuk lidhet drejtpërdrejt me reformën.

Në përfundim të studimeve të ciklit të dytë, kreditet e temës së diplomës të përcaktohen nga programi dhe jo nga lloji i diplomës. Propozohet jo me pak se 30 kredite. Për masterin profesional, nisur nga propozimi për të qenë 60 kredite, nuk krijohen kushte për realizim teme diplome, por të mbetet në realizimin, kryesisht të projekt kurseve (detyrat e kursit përfaqësojnë nivelin më të ulët të punës individuale). Jemi dakort që në përfundim të ciklit të parë të mos ketë më detyrim temë diploma, por sipas rastit në varësi të rezultateve mund të angazhohen student të veçantë.

Masteri ekzekutiv, që propozohet, mendojmë që nuk është kuptuar mirë. Ky nuk është gjë tjetër veçse një Master i Nivelit të Dytë, që e kishim dhe u hodh poshtë se ishte gabim. Masteri ekzekutiv, në vendet nga është huazuar, është një diplomë në nivel Masteri i Shkencës, por që realizohet me kohë të pjesshme.

**Si përfundim,** Këshilli i Fakultetit shpreh mendimin që drafti i parë i propozuar duhet të rishikohet sipas sugjerimeve të ardhura nga stafi akademik, jo akademik dhe studentët. Gjithashtu Këshilli i Fakultetit gatshëm të bashkëpunojë për të kontribuar që reformimi i universiteteve të bëhet në përputhje me specifikat tona dhe në përputhje me hapsirën europiane të arsimit të lartë. Modeli që propozohet nuk i përgjigjet as realitetit tonë dhe as realitetit të vendeve të tjera europiane kontinentale.